



Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe 10, paragrafi 2 dhe nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., nenit 22 paragrafi 3 dhe 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A., me datë 15.09.2025 publikon këtë:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për Llogari të Pagueshme
Koeficienti/Paga: 850€ bruto
Nr. i kërkuar: 1
Kohëzgjatja e emërimit: Në kohë të pacaktuar, periudha provuese 6 muaj
Data e njoftimit: 15.09.2025
Afati për aplikim: 16.09.2025 - 30.09.2025
Institucioni: Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore: Menaxhment
Vendi i punës: Menaxhmenti i Trepça Sh.A.- PIM

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Organizon dhe udhëheq drejtpërdrejtë me punën e punëtorëve në shërbimin e kontabilitetit dhe të financave;
- Koordinon punën e shërbimit dhe përmes ZKF dhe me njësitë tjera në ndërmarrje;
- Përcjell ndryshimet në rregulloret dhe ligjet e natyrës financiare dhe kujdeset për aplikimin e tyre të saktë;
- Përcjellja dhe raportimi i llogarive të pagueshme;
- Regjistrimi i ekstrakteve bankare, të arkave, të shpenzimeve, të mjeteve themelore;
- Evidenton faturat në aplikacion dhe përgatit raportet e duhura për llogaritë e pagueshme;
- Menaxhon kartelën e furnitorëve dhe konfirmon saldon e tyre;
- Evidenton të dhënat në librin kryesor;
- Nxjerr raportet financiare të nevojshme nga libri kryesor;
- Përpunon raportet e kërkuara nga ZKF.

2. Përgjegjësi të tjera të natyrës operative

- Përgatitja e deklaratave tatimore;
- Raporte financiare (Bilanci, Pasqyra e të ardhurave, Raporti për rrjedhën e parasë - Cash flow, Pasqyra e ndërrimeve në eukitet dhe raportimi i tyre në ATK, KKRF);
- Raporte Tatimore (TVSH, Pasqyrat mujore të tatimit në burim “WM”, Pasqyrat Tremujore, Deklarata vjetore e tatimit mbi korporata “CD”);
- Kartelat financiare për furnitorët dhe klientët, duke e bërë edhe planin e pagesave për furnitorët për arsye buxhetore.

3. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

3. Kriteret e veçanta

- I diplomuar në ekonomi, financa, kontabilitet, administrim të biznesit apo master i fushave përkatëse;
- Duhet të ketë së paku 2 vite përvojë profesionale;
- Njohuri e programeve kompjuterike dhe aplikacioneve softuerike financiare.
- Përparësi kanë kandidatët që janë kontabilist të çertifikuar.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” dhe do të njoftohet edhe në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.
Kryeshefi Ekzekutiv

Faton Ahmeti

